



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

NJOFTIM!

Kandidatët pjesëmarrës në provimet për të përfituar titullin Auditues Ligjor ose Kontabilist i Miratuar, kanë të drejtën e ankimimit për rishikimin administrativ të testimit. Kërkesa për rishikim duhet të shoqërohet me dëshminë e kryerjes së pagesës për rishikim e cila është sa gjysma e tarifës së provimit dhe kryhet në të njëjtën llogari bankare ku kandidatët kanë kryer pagesat e tarifave të provimeve.

Ankimi bëhet me shkrim pranë sekretarisë teknike të KPAP-së duke vënë për dijeni BMP, ose drejtpërdrejtë pranë strukturës mbështetëse të BMP-së.

Procesi i rishikimit administrativ kryhet nga persona të përzgjedhur prej strukturës mbështetëse ose ekspertëve të jashtëm, dhe përfshin rishikimin e të gjithë procesit administrativ të lidhur me vlerësimin e kandidatit i cili ka ankimuar rezultatin dhe shpalljen e rezultatit nga KPAP. Në procesin e rishikimit administrativ përfshihet një kopje e procesverbalit përmbledhës të vlerësimit nga secili korrigjues dhe bëhet ri-përlllogaritja e pikëve për secilin kandidat, dhe verifikimin e fletoreve dhe numrit të ushtrimeve të plotësuar nga secili kandidat që ka ankimuar procesin.

Për çdo paqartësi, lutemi mos hezitoni të na kontaktoni në adresën sekretaria.teknike.kpap@ieka.al & info@bmp.al.

Ju urojmë suksese!